

URDHËR I PËRBASHKËT

Nr. 6132/1, datë 16.5.2017

**PËR NDRYSHIMIN E URDHËRIT TË PËRBASHKËT NR. 3069 DATË 14.6.2016 PËR
CAKTIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMEVE PORTUALE NË PORTET DETARE
VLORË, SARANDË DHE SHËNGJIN**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, nenit 84 të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligji nr. 7581, datë 7.7.1992 “Për çmimet dhe tarifafat” i ndryshuar, Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës dhe Ministri i Financave

URDHËROJNË:

Ndryshimin e urdhrit të përbashkët nr. 3069 datë 14.6.2016 për “Caktimin e tarifave të shërbimeve portuale në portet detare Vlorë, Sarandë dhe Shëngjin” si më poshtë:

1. Në kapitullin 1, pika 1.1. “Përkufizime” tek pika 1 “Interpretim” të shtohet germa “e” me përmbajtje:

“e “Anije pasagjerësh” është anija që transporton më shumë se 12 pasagjerë.”

2. Në kapitullin 3, në pikën 3.4. poshtë titullit “Tarifa për shërbimin e heqjes së plehrave për çdo ditë është:” shtohen fjalët:

“Për anijet e mallrave”

3. Në kapitullin 3, pika 3.4. në paragrafin e parë pas germës “g” të hiqet fjala “RO-RO”.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE

Arben Ahmetaj

MINISTRI I TRANSPORTIT

DHE INFRASTRUKTURËS

Sokol Dervishaj